



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 212/1 Prot.

Tiranë, më 06.02.2023

**V E N D I M**

**Nr. 21, Datë 06.02.2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,<sup>2</sup> shqyrtoi ankesën nr. 131, datë 08.09.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”<sup>3</sup>, përfaqësuar nga znj. S.L, Drejtore Ekzekutive, kundër Raiffeisen Bank, Dega Vorë, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara, lidhur me aksesueshmërinë në mjediset e godinës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Fondacioni “Së Bashku” bën me dije KMD-në se që prej muajit prill 2022, është duke zbatuar nismën “*Të rinjtë për gjithëpërfshirjen*”, në Bashkitë Kamëz, Vorë dhe Kavajë. Qëllimi i këtij projekti është edukimi i të rinjve të Bashkive Kamëz, Vorë dhe Kavajë për aktivizimin dhe diversitetin rinor, me synimin përfundimtar krijimin e një grupi për çdo bashki prej 15 aktivistësh, që mund të sjellin ndryshime konkrete, përmirësimin e gjithëpërfshirjes në shërbimet ekzistuese të bashkive dhe ngritjen e ankesave ndaj bashkive për të garantuar një komunitet gjithëpërfshirës për të rinjtë me dhe pa aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër, nga takimet e zhvilluara me personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vorë, është konstatuar se godina pranë së cilës ushtron funksionet e saj Raiffeisen Bank, Dega Vorë nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara. Pala ankuese shprehet se shumë persona me aftësi të kufizuara, të cilët kanë numra llogarie në këtë bankë, për shkak të punës apo për arsye të tjera, nuk mund të kenë akses fizik në godinën e saj. Ankuesi ka dërguar bashkëlidhur ankesës, foto të hyrjes së godinës së

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me “Pala ankuese”

Raiffeisen Bank, Dega Vorë, ku rezultojnë shkallë për të patur akses në hyrjen e saj dhe ku konstatohet mungesa e rampave për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar. Pala ankuese thekson faktin se në këtë godinë mungojnë standardet ligjore për garantimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuara të parashikuara në VKM-në nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar””*.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Bazuar në ankesën e paraqitur, Fondacioni “Së Bashku” pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar lidhur me mohimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), në Raiffeisen Bank, Dega Vorë, për shkak të mungesës së rampës, sipas kritereve të përcaktuara në VKM-në nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””*.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore të aktit normativ, VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””*, nëpërmjet të cilave PAK janë përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Raiffeisen Bank, Dega Vorë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”*.

Bazuar në nenin 4, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare”*.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së Fondacionit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur.

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Fondacioni “Së bashku”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, në kuadër të përfaqësimit të interesave të gjithë grupit të personave me AK, të cilët janë përfitues të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi “aftësia e kufizuar”, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato;

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bankës Raiffeisen, Dega Vorë me shkresën nr. 1204/1, datë 12.09.2022. Shkresa iu dërgua për dijeni edhe Raiffeisen Bank, Selia Qendrore dhe subjektit ankues.

Në prapësimet e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa, KMD kërkoi që të përfshihej informacioni mbi çështjet e mëposhtme, si dhe të dërgoheshin aktet e poshtëcituar:

1. Informacion mbi mënyrën se si garantohen standardet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara (paraplegjikë-tetraplegjike, të verbër dhe persona që nuk dëgjojnë), në godinën, ku ushtron funksionet e saj;
2. Informacion nëse godina ekzistuese është e pajisur me rampa për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave paraplegjikë-tetraplegjike.
3. Informacion nëse ambientet e brendshme të godinës, plotësojnë kushtet e aksesueshmërisë fizike të përcaktuara në Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

*aftësi të kufizuar”, për individët para-tretraplegjikë, personat e verbër dhe personat që nuk dëgjojnë.*

Në vijim të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Raiffeisen Bank, Drejtoria e Përgjithshme, dërgoi shkresën nr. 26840/1, datë 27.09.2022, nëpërmjet së cilës informon se Banka Raiffeisen, Dega Vorë e ushtron aktivitetin e saj në këtë qytet prej shumë vitesh, duke ofruar shërbime bankare për klientët e asaj zone. Dega e bankës ka qenë vendosur në disa ambiente që janë pronë e kësaj banke, në adresë: Pallati i Postës, Vorë.

Si rrjedhojë e dëmtimeve të pësura nga tërmeti i datës 26.11.2019, pallati ku ndodhej godina ku ushtronte veprimtarinë e saj Dega Vorë, u shpall i pabanueshëm nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, nëpërmjet “Akt Konstatimit”, të mbajtur më datë 28.11.2019. Për këtë arsye, duke qenë se duhet të sigurohej vijueshmëria e veprimtarisë së degës së bankës, Banka Raiffeisen ka qenë e detyruar që të marrë me qira një ambient tjetër, derisa të përfundohet ndërtimi i godinës së re, në të cilën Raiffeisen Bank sh.a. do të ketë ambientet pronë të saj. Dega e bankës është e vendosur në godinën aktuale, me adresë: Rr. Rinia, Vorë, në muajin prill të vitit 2020.

Nëpërmjet shkresës nr. 2268/1, datë 26.03.2020, të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Vorë, Banka Raiffeisen është njoftuar se pasuria në pronësi të Raiffeisen Bank, e cila ndodhet në Pallatin e Postës, është përfshirë në programet e rindërtimit.

Aktualisht, kanë filluar punimet dhe është në proces ndërtimi i Pallatit të Postës, ku ndodhej ende edhe Dega e Raiffeisen Bank sh.a. Vorë.

Lidhur me çështjet, për të cilat KMD ka kërkuar informacion me shkresën nr. 1204/1, datë 12.09.2022, Banka Raiffeisen ka informuar si më poshtë:

***“1. Informacion mbi mënyrën si garantohen standardet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara (paraplegjikë-tetraplegjikë, të verbër dhe persona që nuk dëgjojnë).***

*Ju konfirmojmë se Raiffeisen Bank sh.a. në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për të garantuar standardet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuar. Godina fillestare e Degës së Raiffeisen Bank në Vorë ishte në katin përdhe, së bashku me ATM, duke garantuar standardet e aksesueshmërisë edhe për klientët me aftësi të kufizuara. Përveç aksesueshmërisë fizike të degëve, Raiffeisen Bank sh.a. është gjithmonë në kërkim të mënyrave të reja për të lehtësuar aksesin e klientëve të saj në produktet e ndryshme bankare, nëpërmjet zhvillimeve në fushën e teknologjisë digjitale. Aktualisht të gjitha produktet bankare të klientëve të kësaj banke mund të aksesohen lehtësisht nëpërmjet platformës on line Raiffeisen OM (RON), i cili i mundëson klientëve të bankës të verifikojnë gjendjen e llogarive të tyre dhe të kryejnë transfertat dhe pagesat të utiliteteve dhe faturave të tyre. Gjithashtu, stafi i degëve të Raiffeisen Bank ofron asistencë të posaçme për klientët të cilët kanë aftësi të kufizuara, në mënyrë që të lehtësojnë eksperiencën e tyre në bankë. Në disa raste, punonjësit e Bankës asistojnë klientët duke shkuar në banesat e tyre për të nënshkruar dokumentet, kur për arsye shëndetësore klienti nuk mund të paraqitet në degë etj.*

## **2. Informacion nëse godina eksistuese është e pajisur me rampa për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave paraplegjikë-tetraplegjikë.**

*Ish-godina e Raiffeisen Bank sh.a., Dega Vorë e kishte të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave paraplegjikë-tetraplegjikë. Në kushtet e krijuara pas tërmetit të ndodhur në muajin Nëntor të vitit 2019, Raiffeisen Bank është detyruar të marrë me qira një ambient të përkohshëm, për të ushtruar veprimtarinë bankare në qytetin e Vorës, derisa të përfundojë rindërtimi i pallatit ku do të vendoset Dega Vorë. Në kushtet e vështira të krijuara nga tërmeti për të gjithë zonën e Vorës, si dhe me opsionet e limituara në dispozicionin e Raiffeisen Bank për të gjetur një godinë të përshtatshme për të ushtruar aktivitetin e saj, është vendosur marrja me qira e ambienteve në të cilat ushtron veprimtarinë aktualisht Dega Vorë. Në këtë ndërtesë ndodhen edhe degë të bankave të tjera të nivelit të dytë. Në pozicionin ku ndodhet aktualisht Dega Vorë është fizikisht e pamundur të ndërtohet një rampë me parametrat e duhur, nëpërmjet së cilës të aksesohen ambientet e bankës, në mënyrë të sigurtë dhe funksionale. Banka Raiffeisen sqaron se sikurse mund të vihet re edhe nga ilustrimi i skemës së projeksionit të rampës, për shkak të dendësisë së ndërtimeve në zonën, ku ndodhet pallati (nuk ka hapësira të lira për ndërtim rampe), zgjidhjes arkitektonike që ka vetë ndërtesa (shfrytëzim kati gjysmë nëntokë që aksesohet me shkallë nën kuotën e trotuarit dhe shkallë të jashtme individuale për akses të secilit ambient biznesi në katin e parë, si dhe strukturës urbanistike të zonës (trotuare dhe rrugë të ngushta) është fizikisht e pamundur që të ndërtohet një rampë, me parametrat e nevojshëm teknike, për të aksesuar ambientin aktual të Degës Vorë.*

## **3. Informacion nëse ambientet e brendshme të godinës, plotësojnë kushtet e aksesueshmërisë fizike të përcaktuara në Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”, për individët para-tetraplegjikë, personat e verbër dhe personat që nuk dëgjojnë.**

*Theksojmë faktin se Raiffeisen Bank ka marrë masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore, në lidhje me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, stafi i Raiffeisen Bank është gjithmonë i disponueshëm për të asistuar klientët që bëjnë pjesë në këtë kategori, për të lehtësuar në çdo mënyrë të mundshme aksesimin nga ana e tyre të të gjitha shërbimeve të ofruara.*

*Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në mënyrë të përsëritur, në vendimet e saj ka përmblodhur se diskriminimi është trajtim i pabarabartë për shkaqe subjektive si bindja fetare, filozofike, gjinia, etnia, etj (Vendimi Mascoë Branch of the Salvation Army vs. Rissia 2006, pragr. 57-58. Vendimi i Metropolitan Church of Bessarabia dhe të tjerë v. Moldavia, 2001, parag. 114 etj.). Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me një trajtim të pabarabartë për shkak të arsyeve subjektive, por me një situatë të krijuar si rrjedhojë e një dukurie natyrore të paparashikuar (forcë madhore), sikurse ishte tërmeti i vitit 2019, si rrjedhojë e të cilit u ndërpre vijueshmëria normale e punës në godinën e degës së bankës. Ndodhur në kushtet kur godina ekzistuese e Degës Vorë u shpall e pabanueshme dhe si rrjedhojë e opsioneve të limituara të godinave, të cilat konsideroheshin të përshtatshme për ofrimin e aktivitetit bankar, u gjendëm të detyruar të zgjidhnim një godinë të përkohshme, e cila nuk ofron mundësi fizike për të ndërtuar një rampë.*

*Theksojmë edhe një herë se bëhet fjalë për një situatë të përkohshme, që do të zgjidhet me përfundimin e godinës së re që po ndërtohet”.*

Bashkëlidhur shkresës, Raiffeisen Bank ka dërguar aktet e mëposhtme:

- Akt konstatimi i Institutit të Ndërtimit dt. 28.11.2019;
- Shkresë nr. 2268/1 prot., datë 26.03.2020, e Drejtorisë të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vorë;
- Pamje ballore e Degës Raiffeisen Bank, Vorë, përpara shkatërrimit të Pallatit të postës;
- Pamje e aksesit të bizneseve të tjera në të njëjtin objekt;
- Pamje dhe plan të projeksionit të rampës nëse ajo do të zbatohet konform kushteve teknike dhe hapësirave në dispozicion, për akses të ambientit aktual të Degës.

Shkresa e sipërcituar e Bankës Raiffeisen iu dërgua për dijeni subjektit ankues, nëpërmjet e-mailit të datës 30.09.2022.

Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri vendosi realizimin e seancës dëgjimore në datë 07.12.2022. Banka Raiffeisen, Selia Qendrore, Raiffeisen Bank, Dega Vorë dhe subjekti ankues, u njoftuan nëpërmjet shkresës nr. 1204/3, datë 23.11.2022, së KMD-së.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 07.12.2022, në të cilën morën pjesë Fondacioni Së Bashku, i përfaqësuar nga znj. K.S dhe përfaqësuesit me autorizim të Raiffeisen Bank<sup>5</sup>.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Raiffeisen Bank, deklaruan<sup>6</sup> se banka po shikonte mundësinë që të zhvendosej në mjedise të tjera që plotësonin kërkesat e aksesueshmërisë, pasi ndërtesa ku do shkonin është në katin përdhe. Por për këtë kërkonin kohë derisa të përfundonin procedurat.

Në vijim të seancës dëgjimore, Raiffeisen Bank me e-mail-in datë 13.12.2022, informoi Fondacionin Së Bashku se: *“Në vijim të takimit që kishim pranë KMD-së, siç u ra dakord, po ju dërgojmë një përmbledhëse të hapave që po ndërmerr banka, në lidhje me zhvendosjen e degës së Raiffeisen Bank Vorë, në një ambient tjetër:*

- *Banka ka vendosur në prioritetet e saj zhvendosjen e degës Vorë, në një ambient më të madh.*

<sup>5</sup> Referuar autorizimit datë 07.12.2022 të Raiffeisen Bank.

<sup>6</sup> Referuar deklaramentit të bërë në seancën dëgjimore, min. 15.00.

- *Banka ka evidentuar një ambient të përshtatshëm për të transferuar degën Vorë dhe kemi nisur negociatat me pronarin e ambientit dhe kontrollin e dokumentacionit ligjor të pronës.*

*Në bazë të rregulloreve të brendshme të bankës, do të bëhet marrja e aprovimit të organeve drejtuese të bankës, për nisjen e procesit të zhvendosjes. Sapo të firmoset kontrata e qirasë, do të bëhet aplikimi për lejen e ndërtimit nga Bashkia Vorë dhe fillimi i punimeve ndërtimore. Më pas, në zbatim të rregullores përkatëse të BSH, do të bëhet njoftimi i Bankës së Shqipërisë dhe marrja e konfirmimit nga ana e tyre për zhvendosjen e degës.*

*Të gjitha këto procese do të kërkojnë një periudhë kohore, minimumi 3 muaj, maksimumi 6 muaj, në varësi të dokumentacionit, që në disa pika, nuk varet vetëm nga Banka Raiffeisen.*

*Bashkëngjitur do të gjeni një foto të ambientit që po negociojmë, që mundëson aksesin e lirshëm të të gjithë klientëve, përfshirë dhe klientët me aftësi të kufizuara. Banka merr përsipër që të bëjë njoftimin e Fondacionit, në lidhje me ecurinë e procesit të zhvendosjes së degës Vorë”.*

Pasi është njohur me qëndrimin e provat e sjella nga Raiffeisen Bank, përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku”, znj. S.L, nëpërmjet emailit të dërguar me datë 01.02.2023, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë Komisionerit, pasi ka vlerësuar seriozitetin e Raiffeisen Bank dhe masat e ndërmarra prej saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për zgjidhjen e situatës së aksesimit të personave me AK në godinën e Raiffeisen Bank, Dega Vorë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a), nenin 33, pikat 9-10 dhe 11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 131, datë 08.09.2022, të Fondacionit “Së Bashku”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**